



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.767/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Q....shpk, me seli ne Ferizaj adresa 2 Korriku, përfaqësuar nga drejtori E.K., ndaj debitorit N.N.T Sh.... me seli ne fshatin ... Komuna e Klinës përfaqësuar sipas autorizimit nga av. Dren Salihi, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega ne Klinë, CPP.nr.69/20 te datës 18.08.2021, me datën 08.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit N.N.T Sh.... me seli ne fshatin ... Komuna e Klinës, ANULOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë CPP.nr.69/20 te datës 18.08.2021, dhe lënda i kthehet Dhomës së Shkallës se Parë-Departamenti Ekonomik i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Pejë - Dega ne Klinë, me Aktvendimin e ankimuar CPP.nr.69/20 te datës 18.08.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.N.T Sh.... me seli ne fshatin ... Komuna e Klinës, i paraqitur kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit P.nr.628/2020 te datës 03.11.2020 të Përmbaruesit Privat Besnik Aliu, për territorin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë debitori përmes përfaqësuesit te tij te autorizuar av. Dren Salihi, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo të plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te dispozitave ligjore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta refuzoj aktvendimin e gjykatës së shkallës se parë dhe ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet procedurale.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 03.11.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.04/A 2019 te datës 03.04.2019. Përmbarruesi privat Besnik Aliu nga Ferizaj, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.628/20 te datës 03.11.2020, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit sipas faturës t'i paguaj shumën prej 3,645.60€ me kamatë vjetore prej 8 % deri në pagesën definitive.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 16.11.2020, me pretendimin se fatura me të cilën është caktuar përmbarrimi nuk i ka tiparet e përmbarrimit, debitori nuk ka pranuar faturë nga kreditori dhe rrjedhimisht e kundërshton këtë obligim sepse nuk janë plotësuar kushtet nga neni 71 par.1 e LPP. Fatura e cila është lëshuar duhet të përfshij edhe TVSH, e ne rastin konkret kreditori ka lëshuar faturë pa përfshirë TVSH siç kërkon Ligji nr.05/L-037 mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Përfundimisht mund të konkludojmë se fatura nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm apo autentik dhe nuk i plotëson kushtet nga neni 29 par.1.3 dhe neni 71 par.1 te LPP, propozon që gjykata ta aprovoj këtë prapësim, ta shfuqizoj urdhrin për përmbarrim dhe ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet procedurale.

Përgjigje ne prapësim ka bërë kreditori me datën 18.11.2020, me arsyetimin se kreditori me parashtrësë të datës 26.10.2020 ka tërhequr kërkesën për përmbarrim sa i përket faturës 04/ 2019 te datës 03.04.2019 për të cilën faturë kreditori tani ka filluar kërkesën për përmbarrim te njëjtës sipas lendes P.628/2020. Fatura nuk ka të kalkuluar TVSH për arsyet se kreditori i ka ofruar sipas kësaj fature dhe përshkrimit të emërtimit të punës "Shërbime Finishier" dhe për këtë arsye nuk është përfshirë TVSH-ja, dhe kjo çështje duhet të trajtohet nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe jo nga gjykata. Shton se nuk ekzistojnë asnjë nga kushtet për anulim të urdhrin për përmbarrim pasi fatura i plotëson tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29 par.1.3 te LPP, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta vërtetoj urdhrin për përmbarrim dhe ta detyroj debitorin ta paguaj garancionin konform nenit 78 te LPP.

Gjykata Themelore ne Pejë – Dega ne Klinë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerr aktvendim CPP.nr.69/20 te datës 18.08.2021, me të cilin e ka refuzuar ne tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së gjykata pas shikimit të shkresave ne lëndë gjeti se debitori nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për ta bindur gjykatën që urdhri për lejimin e përmbarrimit duhet të anulohet, dëshmitë e ofruara nuk janë të kuptueshme, ndërsa arsyet e debitorit se fatura nuk është dokument i besueshëm nuk qëndron, po ashtu e-maili ne ditët e sotme konsiderohet formë e komunikimit mes subjekteve dhe është dëshmi e mjaftueshme për kreditorin se debitori ka obligime ndaj tij, andaj edhe vlerëson se nuk janë plotësuar arsyet ligjore nga neni 71 i LPP.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkalles se Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 e lidhur me nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, e të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar mirë dokumentet –faturën nr.04/A 2019 e datës 03.04.2019, mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi, kur e njëjta e ka konsideruar si dokument te besueshëm për përmbarim, pasi që nga shkresat e lëndës shihet qartë se fatura në bazë të cilës është lejuar përmbarimi është e pa nënshkruar nga ana e debitorit, dhe e pavulosur, dhe si e tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore neni 29 par.1 nenpar.1.3 të LPP-së. Po ashtu fatura nuk posedon asnjë elementet konform par.3 te nenit 29 te LPP i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, e qe ne rastin konkret fatura pos vërejtjeve te mësipërme nuk posedon as afatin kohor të përmbushjes së detyrimit.

Andaj, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të shqyrtoj prapësimin, në kuptim të dispozitave të lartcekura, të analizohen dhe vlerësohen edhe një herë provat përkatësisht fatura dhe e-maili, e më pastaj duke vlerësuar edhe shkaqet ligjore nga neni 71 të LPP-së, të vendos konform dispozitave ligjore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika (d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,
DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.767/22 me datë 08.11.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha